



BULETINI INNOVET ALBANIA

Le të kontribuojmë drejt një komuniteti më të fortë të Arsimit dhe Formimit Profesional!



I dashur lexues,

Kemi kënaqësinë që këtë buletin të 15-të dhe të fundit për vitin 2023 ta hapim me një artikull nga Silva Sufali, mësuese pranë Shkollës 9-vjeçare Pajovë në qytetin e Peqinit. Më poshtë do të lexoni artikullin e përgatitur nga Silva, e cila ka shprehur mendimet dhe na ka njohur me eksperiencën e saj.

Përshendetje lexues të dashur, unë quhem Silva Sufali Cani. Lindur dhe rritur në një qytet të vogël, por me histori të madhe më 10.06.1987, Peqin.

Studimet e para i kam kryer në qytetin e lindjes për të vazhduar më tej në një prej universiteteve më të mira në vend, siç është edhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.

Pasioneve të shumta dhe aktivizmit në jetën shoqërore e sociale iu shtuan edhe studimet e thelluara në degën e Matematikës, duke ndjekur të gjitha nivelet arsimore e diplomuar në Master Shkencor "Matematikë e Zbatuar".

Gjatë punës time si mësuese në disa shkolla të rrethit spikat dashuria dhe angazhimi i përgjegjshëm qytetar për të çuar përpara brezat e për t'u dhënë atyre shembullin e një njeriu të lirë, me integritet të lartë e dashuri të pakufi për vendin e tij.

Disa momente kyçe që kanë bërë një kthesë të madhe në raportin individ qytetar është edhe pjesëmarrja në konferencën e 35-të European School, për laboratorët virtualë në platformën Go-Lab. Këto njohuri janë vlerësuar e janë futur edhe si një pjesë e veçantë në kurrikulën shkollore të lëndëve shkencore për Arsimin Parauniversitar.



Përgjatë vitit 2023, i një rëndësie të veçantë për aktivizimet e mia ka qenë edhe të qenit pjesë si Koordinatore Lokale Bashkia Peqin në Projektin Rin'Akt në bashkëpunim me Albanian Skills.

Pjesë e këtij projekti ishte dhe Akademia Rin'Akt, e cila u implementua përgjatë tre ditëve në qytetin e Peqinit, ku bashkëpunëtorët tanë na e bënë më të bukur dhe më tërheqëse etapën e tij.

Vizita në kalanë e Shkodrës, si dhe Shkëmbimi i kryer me të rinjtë e Kurbinut i dha atyre një mundësi bashkëpunimi, rakordim idesh, lidhje urash komunikimi për nisma të tjera që do të pasojnë në vijim. Angazhimi i të rinjve dhe pjesëmarrja e qytetarëve të Peqinit në marshimin ndërgjegjëses dhe kërkesat përsa i përket infrastrukturës, bënë të mundur që këta të rinj t'i kryejnë me sukses nismat e tyre.


Ky projekt aftësoi të rinjtë e Bashkisë Peqin dhe i mundësoi atyre njohuri të thelluara përsa i përket angazhimit qytetar, lëvizjeve demokratike dhe ngritjes së zërit në mënyra të ndryshme. Për mua si mësuese prej vitesh dhe pjesë e shoqërisë civile, projekte të tilla janë me shumë vlerë, pasi ndihmojnë që të rinjtë të jenë më aktiv dhe të përgjegjshëm për veprimet që ato ndërmarrin në jetën e përditshme. Pas realizimit të këtij projekti, të rinjtë pjesëmarrës ndihen më të motivuar dhe më me shumë informacione e njohuri.

Në këtë numër do të lexoni:

- Artikull nga Silva Sufali-Eksperienca ime me Albanian Skills dhe Projekti Rin'Akt
- Takimi i SFIDAVE RIN'AKT - Shkëmbimi Rinor midis të Rinjve të Bashkive Kurbin dhe Peqin.
- Konkursi i Shkollave Profesionale, me drejtime mësimore në bujqësi, blegtori dhe kopshtari 2023
- Aktivitetet e Projektit Intervet WB
- Eventi Final i Projektit Intervet WB
- Ilaria Bogdani - Eksperienca ime me projektin Intervet WB
- Përvoja e studentëve italianë në realizimin e praktikës pranë kompanive shqiptare.
- Projekti V2V- Albania, Vizitë studimore në Alba, Itali dhe Lion, Francë.
- "Festivali i Aftësive, Karrierës dhe Punës" Edicioni i Parë dhe Konkursët Kombëtare Profesionale Edicioni i- 8

Në numrin e ardhshëm:

- Përvojat e nxënësve gjatë lëvizshmërisë për të mësuarit në Alba, Itali dhe Lion, Francë.
- Studentët nga Italia-- Përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, në kuadër të Erasmus+
- Festivali i Aftësive, Karrierës dhe Punës 2024- Edicioni i Dytë.
- Edicioni 9-të i Konkurseve Kombëtare të Aftësive Profesionale
- Aktivitetet e Projekteve Erasmus + Zhvillim Kapacitetesh për



TAKIMI I SFIDAVE RIN'AKT - SHKËMBIM RINOR MIDIS TË RINJVE TË BASHKIVE KURBIN DHE PEQIN

Projekti RIN'AKT paraqet përpjekje plot motivim të një grupi të vendosur të rinjsh për të krijuar një të ardhme të rritjes personale dhe mirëqenies komunitare. Përmes ideve inovative dhe veprimeve konkrete, ata synojnë të krijojnë ndikim, duke dhënë shembuj pozitivë në mjedisin, ku jetojnë e veprojnë.

Të rinjtë aktivë në këtë projekt vijnë nga dy qytete të ndryshme: nga Kurbin dhe Peqini. Këta të rinj nisën punën e tyre që nga gushti i vitit 2023., ku fillimisht ata iu nënshtruan trajnimeve tre-ditore në qytetin e tyre. Përgjatë periudhës gusht-tetor 2023, grupet e punës punuan për realizimin e nismave të ndërmarra, duke realizuar plane pune të ndryshme e hapa konkretë.

Më 29 tetor 2023, gjatë një Shkëmbimi Rinor në Shkodër, të rinjtë e të dy qyteteve punuan së bashku te Qendra Rinore "Arka", për të finalizuar draft-planet e tyre në lidhje me nismat dhe hartuan planin e veprimeve për t'i zbatuar ato në vijim. Ky takim shërbeu gjithashtu edhe për ndarje përvojash, konsultim i mëtejshëm dhe konsolidimi i bazave për vijimin e veprimtarive.



Kjo ditë nisi me një vizitë në kalanë e Shkodrës dhe vazhdoi me një punë intensive në grup. Nga ora 10:00 deri në 13:30, u zhvillua një mbledhje fillestare, kushtuar planifikimit të veprimtarive të punës dhe më pas pjesëmarrësit u grupuan sipas qyteteve për të punuar për nismat e tyre.

Dy nismat me të cilat të rinjtë e Kurbin punuan me përkushtim janë përmirësimi i sinjaleve rrugore, me synim rritjen e sigurisë rrugore dhe parandalimin e bullizimit nëpër shkolla dhe mjedise të tjera.

Ndërkohë, grupi i Peqinit punoi me nismat që lidhen me ndërgjegjësimin kundër shpyllëzimit të Pylli i Pishave në Peqin, mbajtjen pastër të mjediseve të përbashkëta publike të qytetit, duke ndërmarrë përsipër organizimin e një fjalimi para godinës së Bashkisë dhe marshimin drejt pyllit, me qëllim ndërgjegjësimin e sa më shumë qytetarëve.



Forca e këtij projekti qëndron në solidaritet. Ky projekt ka edhe synimin e lehtësimit të bashkimit të të rinjve nga qytete të ndryshme, për të krijuar një mjedis më të këndshëm për socializim, i cili mund të krijojë mundësinë për të ndihmuar njëri-tjetrin në projektet që kanë për qëllim të kryejnë në një të ardhme të afërt.

RIN'AKT kontribuoi në një komunitet më të fortë, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Kjo përvojë nuk po formon vetëm të ardhmen e këtyre të rinjve, por po kontribuon gjithashtu në vitalitetin dhe rritjen e qyteteve të Kurbin dhe Peqinit. Ajo qëndron si një fener shprese dhe frymëzimi për banorët e këtyre komuniteteve të vogla, duke ilustruar se ndryshimi pozitiv fillon pak nga pak.

KONKURSI I SHKOLLAVE PROFESIONALE, ME DREJTIME MËSIMORE NË BUJQËSI, BLEGTORI DHE KOPSHTARI 2023

Pranë ambjenteve të Expocity Albania, për të dytin vit me radhë, nën vazhden e aktiviteteve të panairit më të madh në vend të bujqësisë, blegtorisë dhe kopshtarisë, u zhvillua gjithashtu edhe Konkursi i Shkollave Profesionale, me drejtime mësimore në bujqësi, blegtori dhe kopshtari.

Ky konkurs u mbështet gjithashtu nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe AlbanianSkills.



Në këtë konkurs morën pjesë 6 shkolla profesionale me idetë:

- Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz - “Ruajtja e frutave të ndryshme për periudha të gjata me metodën e mbledhjes me letër dhe folie alumini.”
- Shkolla e mesme profesionale “Charles Telford Erickson” - “Rritja e ushqimit të gjelbër për blegtorinë.”
- Shkolla e mesme profesionale “Rakip Kryeziu” Fier - “Kultivimi i bimëve në sistemin hidroponik me gjysmë tretësirë.”
- Shkolla Mihal Shahini - “Pa bletë, s’ka jetë. Rëndësia e tyre në biodiversitet.”
- Shkolla Profesionale Shërbime Korçë - “Ruajtja e farës së qepës autoktone.”
- Shkolla Profesionale Kombetare “Ndre Mjeda” Bushat - “Bima Komfrej dhe përdorimet e saj kurative.”



Grupet përfaqësuese të këtyre shkollave prezantuan ide inovatore dhe me interes për investim nga bizneset partnere për implementimin e mëtejshëm të tyre. Juria e përbërë nga përfaqësues të bizneseve vlerësuan idetë në bazë të 4 kriterëve: risia që sjell, qëndrueshmëria, zbatimi dhe prezantimi i idesë.

Shkollat triumfuese me pikët më të larta të grumbulluara janë:

- Çmimi i parë: Shkolla “Mihal Shahini”
- Çmimi i dytë: Shkolla e mesme profesionale “Charles Telford Erickson”
- Çmimi i tretë: Shkolla Profesionale Kombetare “Ndre Mjeda” Bushat

Ky konkurs është një shembull i shkëlqyer i potencialit të rinisë në shkollat profesionale dhe dëshmon qartë se inovacioni dhe kreativiteti kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në vendin tonë.

Të gjithë pjesëmarrësit meritojnë falënderim për përpjekjet dhe kontributin e tyre në promovimin e kësaj fushe aq të rëndësishme për ekonominë tonë.





AKTIVITETET E PROJEKTIT INTERVET WB

Që prej Dhjetorit të 2019-ës, projekti “Internationalisation of VET Systems in Western Balkans - INTERVET WB”, i financuar nga BE ka prezantuar kulturën e lëvizshmërisë për të mësuarit në sistemet e arsimit dhe formimit profesional të vendeve pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor, duke zhvilluar në to modele dhe procedura që lejuan organizimin e punësimit jashtë vendit, përmes organizimit të praktikave profesionale një dhe tremujore dhe të mësuarit gjatë punës, për më shumë se 400 studentë dhe trajnimin për 200 mësime dhënësit e drejtuesit e institucioneve të arsimit profesional.



INTERVET WB ka qenë një projekt i cili ka lënë gjurmë në arsimin profesional shqiptar për sa i përket mobiliteteve të nxënësve. Fatkeqësisht, ky ishte viti i fundit i projektit, por i hapi rrugë Mobiliteteve të nxënësve dhe mësuesve të arsimit profesional në Shqipëri për mobilitetet në vendet perëndimore.

Në vendin tonë përgjatë gjithë implementimit të projektit kanë fituar mundësinë e realizimit të praktikës së punës 1-mujore ose 3-mujore rreth 100 nxënës të shkollave profesionale dhe pjesëmarrës në programe të ndryshme si: Puna në Hije, Shkollat Verore, Java e mësuesve rreth 21 mësues.

Shqipëria ka qenë një nga vendet në Ballkanin Perëndimor me një numër të lartë aplikimesh dhe interesi nga nxënësit dhe mësuesit. Ky projekt ishte një sukses i vërtetë për të gjithë, sukses i cili nuk mund të arrihej pa mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të gjithë drejtuesve të shkollave profesionale, nxënësit dhe mësuesit aplikues dhe familjarët e tyre. Një rrugëtim i gjatë e i mbushur me sfida nga më të ndryshmet, por gjithmonë kur puna bëhet me dashuri ia arrihet që rezultati të jetë sa më i suksesshëm.



Ne si Albanian Skills mbajtëm eventin final të projektit më datë 22 Shtator 2023, pranë ambjenteve të Europe House me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, mësues dhe nxënës pjesëmarrës në projekt, nën moderimin e Edlira Birkos dhe mbështetjen e Televizionit Shqiptar.

Ishte një ndjenjë e veçantë që të shikoje të gjithë këto aktorë, kontribues, mbështetës dhe pjesëmarrës në projekt në një sallë. Përgjatë këtij eventi u fol për eksperiencën që vetë mësuesit, nxënësit dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse kanë pasur gjatë implementimit të këtij projekti.



Rrugëtimi 4-vjeçar i projektit u përmbyll në konferencën finale në Bruksel. Konferenca filloi me një hyrje bindëse të projektit INTERVET WB, rezultatet e tij dhe zhvillimet e ardhshme të sistemeve të AFP-së. Suksesi i projektit INTERVET WB pasqyron një angazhim të palëkundur për fuqizimin e nxënësve dhe mësuesve të AFP-së. Ky projekt e ka bërë realitet mobilitetin e të mësuarit, duke pasuruar jetën e studentëve dhe stafit të AFP-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Ngritja e kapaciteteve të AFP-së ishte tema e radhës e konferencës. Ai filloi me një vështrim se si AFP shkon përtej kufijve, duke theksuar ndikimin e tij në mundësitë e punësimit në Ballkanin Perëndimor. Prezantimi, i udhëhequr nga EACEA, e bëri të qartë se AFP nuk është vetëm një gjë lokale; ka lidhje globale.

Përfaqësuesi nga DG-EAC foli për aktivitetet ndërkombëtare në AFP, duke theksuar ndikimin e tyre në punësueshmërinë në nivel kombëtar.



Në konferencë, diskutimet u rrotulluan rreth garantimit të qëndrueshmërisë së projektit, përsosjes së strategjive të shpërndarjes dhe ruajtjes së standardeve të cilësisë. Këto biseda ishin një dëshmi e përkushtimit të të gjitha palëve të përfshira.

Për vende si Shqipëria, projekti INTERVET WB ka hapur dyert për mundësi të pashembullta për studentët dhe mësuesit e AFP-së. Ky projekt pilot, i drejtuar nga profesionistë në 14 vende, i ka shndërruar ëndrrat në realitet.

Ne jemi thellësisht të lumtur për përmbylljen me sukses të këtij projekti dhe hapjen e mundësive të tjera për arsimin profesional në Shqipëri.



Më poshtë do të lexoni dhe një artikull të përgatitur nga Zyra e Delegacionit të Bashkimit European Tiranë në bazë të eksperiencës së nxënëses së Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë, Ilaria Bogdani, e cila ka folur për eksperiencën e saj përgjatë realizimit të mobilitetit të saj në Lion të Francës dhe si kjo eskperiençë ka ndikuar në jetën e saj profesionale dhe personale.

Ilaria Bogdani ishte 18 vjeç kur falë një projekti të mbështetur nga BE do të bënte udhëtimin e saj të parë jashtë Shqipërisë. “Ishte një mundësi e artë për mua për të parë botën dhe për të marrë përvojën time të parë të punës në Evropë,” thotë ajo me entuziazëm.

Ilaria ishte studente e vitit të tretë në Shkollën Ekonomike Teknike Profesionale të Tiranës kur dëgjoi për programin INTERVET dhe aplikoi menjëherë. Unë aplikova dhe fitova”, thotë Ilaria, e cila ishte fituese në krye të listës. Fati i Ilarias ishte të shkonte në Lyon për të zhvilluar praktikën e saj në qendrën e trajnimit profesional SEPR, një nga më të vjetrat dhe më të mëdhatë në Francë.



“Puna jonë konsistente në ndërtimin e faqes së internetit të Shkollës SEPR. Por së pari, na u desh të hulumtonim faqe interneti të ngjashme të shkollave AFP, të analizonim konkurrentët dhe të krijojmë një Excel me të gjitha të dhënat që mblodhëm. Më pas krijuam përmbajtje bazuar në vlerat më të mira të shkollës SEPR dhe autenticitetin e saj”, thotë ajo, duke shtuar se njohuritë që mori ishin të çmuara për të vazhduar arsimimin e saj.

Kjo eksperiencë i mësoi asaj shumë më tepër: “Më bëri më shumë përshtypje kultura e punës, komunikimit dhe motivimit, elementë që nuk i gjen në praktikën e punës në Shqipëri”. Ajo mësoi gjithashtu të jetojë vetëm, të jetë më e pavarur dhe të dijë për kulturën dhe traditat e vendit pritës. “Gjatë kohës së lirë vizituam vende të reja si Bellecour, Saint Jean, Fourviere, Planetarium, Parc de la Tête d’Or, Traboule, Jardin du Rosaire dhe Teatro Gallo Roman,” shtoi ajo.

Pas kthimit, ajo ka ide më të qarta për të ardhmen e saj. E rikthyer nga Lion, ajo përfundoi vitin e katërt të Shkollës AFP në Tiranë dhe aplikoi për në Universitet. “U pranova në Informatikë Ekonomike dhe tani jam studente në Tiranë. Vitin e ardhshëm dua të aplikoj për programin Erasmus; Nuk ka rëndësi në cilin vend të BE-së”, thotë Ilaria. Por unë do të kthehem. Është mirë të marrim arsimin dhe përvojën më të mirë në vendet evropiane dhe të kthehemi për të ndërtuar vendin tonë”, shton ajo.

Me këtë artikull të Ilarias mbyllim dhe artikujt për projektin INTERVET WB, projekt i cili impakti i tij do të mbetet gjatë në kujtesën e të gjithëve. Mirënjohje të pafundme për të gjithë aktotët e përfshirë në projekt.



PËRVOJA E STUDENTËVE ITALIANË NË REALIZIMIN E PRAKTIKËS PRANË KOMPANIVE SHQIPTARE



Më datë 16 Shtator 2023 deri me 17 Tetor 2023, Albanian Skills mikpriti grupin e tretë të nxënësve italianë të cilët realizuan praktikën 1-mujore pranë kompanive shqiptare. Grupi i tretë që erdhi ishte i përbërë nga shtatë nxënës dhe shoqëruesja e grupit. Ato u pritën nga stafi i Albanian Skills dhe u akomoduan pranë Art Hostel. Specifikisht nxënësit realizuan praktikën e tyre pranë kompanive:



Serena Rustici dhe Diego Capoferri realizuan praktikën e tyre pranë Aladini (Shop), ku kishin përgjegjësinë e etiketimit, çmimet e produkteve dhe krijimi i historive dhe postimeve tërheqëse në Instagram. Përvoja e tyre në Aladini u lejoi atyre të kombinojnë aftësitë organizative me kreativitetin e tyre, duke rezultuar në përmbajtje magjepsëse rrjetet sociale. Ata ndihen krenarë për kontributin në kompani.


Mateo Bicorgni realizoi praktikën pranë Build Green Group Abania, ku ishte i fokusuar në krijimin e postimeve në media sociale pro mjedisit. Ai ka kontribuar aktivisht në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore përmes përmbajtjeve tërheqëse dhe informative. Përvoja e tij në Build Green Group e ka lejuar atë të kombinojë pasionin e tij për mjedisin me aftësitë e tij krijuese, duke bërë përfundimisht një ndryshim në përhapjen e mesazheve eko-miqësore përmes mediave sociale.

Elidon Xholi dhe Othman Kirane realizuan praktikën e tyre pranë Albanian Skills. Përgjatë praktikës së tyre djemtë arritën të përdorin aftësitë e tyre në marketing dhe shkenca kompjuterike. Ata patën mundësinë që zbatojnë ekspertizën e tyre në promovimin e organizatës dhe përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar punën e saj. Othmani dhe Elidoni gjetën kënaqësi në shfrytëzimin e talenteve përkatëse për të kontribuar në suksesin e Albanian Skills dhe përvojën e tyre që i lejoi ata të zhvillonin më tej aftësitë e tyre në marketing dhe shkenca kompjuterike.



Agnese Baccari punoi në Junior Achievement of Albania dhe pati një përvojë të vlefshme në organizimin e eventeve rinore. Ajo kontribuoi në planifikimin dhe ekzekutimin e ngjarjeve të ndryshme që synonin angazhimin dhe fuqizimin e individëve të rinj. Puna e saj në Junior Achievement e ndihmoi atë të ketë një ndikim pozitiv në komunitetin rinor dhe të frymëzojë të rinj të tjerë.

Lara Sofia punoi si recepsioniste në Hotel Colosseo Tirana dhe asaj i pëlqeu shumë kjo punë. Roli i saj përfshinte mirëseardhjen e mysafirëve, trajtimin e check-in-eve dhe check-out-eve dhe asistimin e tyre, duke iu përgjigjur çdo pyetjeje apo kërkesë që mund të kishin ata. Përgjatë kohës si praktikante ajo ishte shumë e lumtur në pozicionin që kishte, pasi nëpërmjet punës bashkëvepronte me njerëz me prejardhje dhe kultura të ndryshme. Duke punuar në Hotel Colosseo Tirana, Sofia ka arritur që të zhvillojë aftësitë e saj të komunikimit dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.





Pas largimit të grupit të tretë të nxënësve përgjatë periudhës 17 Tetor 2023 deri me 18 Nëntor 2023 ne mikpritëm grupin e katërt të nxënësve italianë që do të realizonin praktikën 1-mujore pranë kompanive shqiptare.

Ky grup ishte i përbërë nga gjashtë nxënës të shoqëruar dhe Marta, shoqëruesja e grupit. Nxënësit realizuan praktikatat e tyre në kompanitë:

- Elena Sofia Grossi dhe Alex D'angelo realizuan praktikën e tyre 1-mujore pranë Destil Creative Hub.
- Chiara Lusha ka realizuar praktikën 1-mujore pranë Albanian Skills.
- Arianna Sestili ka realizuar praktikën e saj një pjesë pranë Timak dhe një pjesë pranë Albanian Skills.
- Angelica Musacchio ka realizuar praktikën pranë Build Green Group Albania.
- Sebastiano Paci ka realizuar praktikën pranë Timak.

Më poshtë ju do të mund që të lexoni një artikull të përgatitur nga Chiara dhe Arianna ku mund të njiheni më me detaje për eksperiencën që nxënësit kanë pasur përgjatë praktikës 1-mujore në Shqipëri.



Aventura jonë filloi në aeroportin e Ankonës, ku u mbledh i gjithë grupi: Alex, Sebastiano, Angelica, Arianna, Elena, Chiara dhe drejtuesja e grupit tonë, Marta.

Që në ditën tonë të parë në Tiranë, organizata pritëse "Albanian Skills" na prezantoi vendin me një darkë tipike dhe ndau atë që na priste në javët në vijim. Falë Albanian Skills, patëm mundësinë të eksploronim dy qytete të rëndësishme të Shqipërisë. I pari ishte Shkodra, i pasur me kulturë në çdo cep, me kalanë e tij që ofronte një pamje të mrekullueshme të peizazhit. E dyta ishte Kruja, ku "Pazari" dhe kalaja e saj na çuan në një epokë tjetër.





Gjatë fundjavave ne organizuam dhe një udhëtim në qytetin e Beratit. Berati, i vendosur në pjesën jugore të Shqipërisë, është i njohur për qytetin e vjetër të shpallur nga UNESCO, i karakterizuar nga shtëpitë e bardha përgjatë maleve dhe një kështjellë. Durrësi, në bregdetin e Adriatikut, krenohet me plazhet, një port detar dhe një amfiteatër historik romak, një gjë që duhet parë nga çdo turist.

Përvoja jonë e punës ishte shumë formuese. Chiara ndihej rehat duke punuar me ekipin e Albanian Skills, duke u angazhuar në kërkime, takime dhe projekte aktivizmi. Arianna filloi në departamentin e marketingut të Timak, duke krijuar dhe publikuar video. Sebastiano ndihmoi punëtorët në prodhimin e automjeteve në Timak dhe Angelica punoi në komunikim dhe marketing në "Build Green Group", një organizatë jofitimprurëse e fokusuar në çështjet mjedisore. Alex dhe Elena punuan si kamerierë dhe barmenë në qendrën Destil Creative Hub, duke fituar përvojë të vlefshme në gjuhën dhe ndërveprimin me klientët.



Të jetuarit së bashku në një hostel ishte një aspekt kryesor i përvojës sonë, duke nxitur lidhjet dhe duke na ekspozuar ndaj njerëzve të etnive dhe kulturave të ndryshme. Shumë shoqërues ndërkombëtarë pasuruan sfondin tonë kulturor, duke krijuar një përzierje unike përvojash dhe zakonesh. Pavarësisht sfidave fillestare në respektimin e rregullave, ne mësuam ta shohim secilin kriter si një "mësim respekti", duke kontribuar në rritjen tonë personale.

Gjatë gjithë këtij udhëtimi Erasmus, ne eksploruam Shqipërinë, u thelluam në kulturën e saj, vizituam vende të reja dhe mësuam për historinë shqiptare përmes vizitave në muze. Pavarësisht disa sfidave, përvoja ishte e këndshme, duke nxitur pavarësinë, bashkëpunimin dhe rritjen personale. Kuzhina e larmishme shqiptare, duke përfshirë të preferuarat si petulla, byreku dhe suflaqe, i shtuan pasurinë tonë kulturore dhe eksperiencës.



PROJEKTI V2V - ALBANIA, VIZITË STUDIMORE NË ABA, ITALI DHE LYON, FRANCË

Përgjatë periudhave 6-11 Nëntor 2023 dhe 28 Nëntor-02 Dhejtor 2023 u mbajtën vizitat studimore në kudër të projektit V2V Albania, i cili ka nisur në Janar 2023 dhe po implementohet në Shqipëri në dy shkollat profesionale: Shkolla profesionale Kamëz dhe Shkolla Hoteleri-Turizëm Tiranë. Albanian Skills si partnere në projekt mori pjesë në vizitat studimore. Kjo vizitë studimore u organizua nga organizata pritëse Apro Formazione. Pjesë në vizitën studimore në Alba, Itali si përfaqësues të Albanian Skills ishin: Alma Shkreli bashkëthemeluese dhe anëtare bordi e AlbanianSkills dhe Martin Gjonaj, anëtar jurie i Konkurseve Kombëtare në kategorinë "Shërbim Hotelier dhe Restorant" prej vitit 2017.



Axhenda përfshinte prezantime, ekspozita, aktivitete kulturore dhe vizita në kompani partnere, duke ofruar njohuri mbi arsimin profesional në zhvillim. Vizita studimore filloi me një hyrje në rolin dhe angazhimin e Apro Formazione për përsosmërinë në arsimin profesional. Theksi u vu në strategjinë e ndërkombëtarizimit të Apro Formazione, duke u fokusuar në lëvizshmërinë, inovacionin dhe rrjetëzimin. Gjithashtu, u eksplorua rëndësia e lëvizshmërisë, inovacionit dhe rrjetëzimit në pasurimin e arsimit profesional.

Gjatë ditës së dytë u diskutua për shërbimet e punës, duke përfshirë vendosjet në punë dhe analizën e kompetencave për përgatitjen praktike të studentëve. Kjo vizitë studimore paraqiti aktivitete kulturore të lidhura me Panairin Ndërkombëtar të Tartufit të Bardhë, duke ofruar një pamje tërësore të pasurisë së rajonit dhe gjithashtu një turne në qytet. TCN ofroi një vështrim të drejtpërdrejtë në marrëdhënien simbiotike midis AFP-së dhe teknologjisë, duke u mundësuar pjesëmarrësve të kuptojnë më shumë rreth këtij aspekti. Vënia në pah e rëndësisë së aftësive të buta dhe të jetës në arsimin profesional, përgatitja e studentëve për karrierë dhe më gjerë është gjithmonë e denjë, ndaj nuk mund të anashkalohet në këtë vizitë studimore. Pika e fundit e diskutimit ishte strukturat e sistemit të dyfishtë dhe praktikatat si metoda efektive për të zhytur studentët në mjediset reale të punës.

Në përgjithësi, kjo vizitë studimore në Alba, Itali, i pasuroi pjesëmarrësit me strategji novatore dhe përpjekje bashkëpunuese në ndërkombëtarizimin e arsimit profesional për ta bërë atë më të mirë për të gjitha palët.






Përgjatë periudhës 28 Nëntor-02 Dhjetor 2023, SEPR në Lyon Francë ishte organizata pritëse e cila organizoi vizitën tjetër studimore ku si përfaqësues të Albanian Skills ishin: Arlinda Baçi dhe Dorina Islami. Arlinda dhe Dorina janë të dyja bashkëthemeluese dhe anëtare bordi të AlbanianSkills.

Axhenda e takimit përfshinte: Prezantimin e Sistemit AFP të Francës, njohja me sistemin dhe diskutimi rreth sistemit dhe krahasimi me sistemin shqiptar; Pedagogjia e të nxëniet të bazuar në punë, Prezantimi i mjedisit të pedagogjisë inovative, Trajnim i vazhdueshëm dhe bashkëpunim me kompanitë; Menaxhimi i Cilësisë; Biblioteka Miltumedia; Departamenti Ndërkombëtar; Vizitë në kompani dhe njohja me ato; Feedback per trajnimet e zhvilluara dhe ditët e kaluara në SEPR.

Këto dy vizita ishin mjaft frytdhënëse dhe mjaft bashkëpunuese dhe patën një ndikim pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet. Aktivitete të tilla janë një mënyrë e mirë për t'u rrjetëzuar dhe ndihmojnë në zhvillimin e mëtijshëm të arsimit profesional.



“FESTIVALI I AFTËSIVE, KARRIERËS DHE PUNËS” EDICIONI I PARË DHE KONKURSET KOMBËTARE PROFESIONALE EDICIONI I- 8

“Festivali i Aftësive, Karrierës dhe Punës” Edicioni i parë dhe Konkursset Kombëtare Profesionale Edicioni i- 8 u mbajtën në datat 13-15 Dhjetor 2023 pranë ambjenteve të Expocity Albania. Ky aktivitet u bashkëorganizua nga Albanian Skills dhe Expocity Albania. Tre ditë të mbushura me entuziazëm, emocione, energji dhe plot e përplot me aktivitete e panele të ndryshme përmbajtësore.



Grupi artistik i nxënësve të Shkollës Profesionale Kamëz hapi siparin e këtyre aktiviteteve të cilët kërcyen valle popullore shqiptare. Pas kësaj hapie aq të këndshme, nisën garat profesionale sipas kategorive : Konkursi i Sipërmarrjes dhe Zhvillimit të Biznesit; Konkursi i Kuzhinës; Konkursi i Dizajnit Grafik; Konkursi i Fotografisë; Konkursi i Zhvillimit të Software; Konkursi i Zhvillimit të Web; Konkursset për të Diplomuarit në shkolla profesionale drejtimi Hoteleri-Turizëm mundësuar nga Projekti Erasmus+ VET TO VET ALBANIA, pas rregjistrimit të konkurrentëve, dhe prezantimit me jurinë dhe detyrat përkatëse .

Përgjatë ditës së parë u realizuan panelet tematike;

·Viti Evropian i Aftësive, Tranzicioni i drejtë dhe i gjelbër: Z. Roman Boitard, Koordinator për Shqipërinë, Këshilltar për gjelbërimin, Njësia e Këshillimit të Politikave, European Training Foundation (ETF),

-BE mbështet zhvillimin e aftësive në Shqipëri kontributi dhe sfidat në zbatimin e tyre.,Z. Michael Johnson, Project Manager, EU4SI.

-Ngritja e Kapaciteteve Erasmus+ për AFP-në (projektet Erasmus+ në Shqipëri),Zj. Ada Ramaj, National Coordinator, Albanian Erasmus + Office;

·Zhvillimi aftësive dhe angazhimi i sektorit privat në arsimim dhe aftësim profesional parë me sytë e të rinjve. Znj. Aulona Hoxha, CEO, EXPOCITY Albania, Z. Engjell Rraklli, CEO, Division 5, Z. Athanasios Canko, CEO, SFC Albania, Firdeus Kasaj, nxënës në AFP dhe Erik Havari nxënës në AFP.

·**Seminar dyditor:** Si teknologjia dhe IA po ndryshojnë botën e punës; aplikime në Industrinë e Mikëpritjes. Jorizon Education Consulting (Joy Dong) & Amazing Experience Hospitality Consulting (Andy He), China Skills; Si të transformoni konkurset e aftësive në mësimdhënie në klasë? Si të përdoret IA për trajnimin në shërbimet e hotelerisë dhe mikëpritjes.

Kështu u mbyll dita e parë e mbushur me punë, panele, diskutime, të rinjë entuziastë dhe të përkushtuar.





Dita e dytë nisi më e qetë dhe konkurrentët filluan punën me detyrat përkatëse sipas kategorive. Kategoritë që konkuruan në ditën e dytë ishin: Konkursi i Sipërmarrjes dhe Zhvillimit të Biznesit; Konkursi i Kuzhinës; Konkursi i Dizajnit Grafik; Konkursi i Fotografisë; Konkursi i Zhvillimit të Software; Konkursi i Zhvillimit të Web; Konkursët për të Diplomuarit në shkolla profesionale drejtimi Hoteleri-Turizëm, mundësuar nga Projekti Erasmus+ VET TO VET ALBANIA; Konkursi i Kuzhinës.

Përgjatë ditës së dytë u zhilluan këto panele tematike;

“Edukimi Ekonomiko-Financiar” (Banka e Shqipërisë) Z. Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve, Znj. Valentina Semi, Zëvendësdyrektore e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës;

Praktikë pune në hije për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave profesionale pjesëmarrëse në Erasmus+ VET 2 VET ALBANIA, “Si të aftësojmë adoleshentët për aftësitë e tyre jetësore”, trajnere Dr. Chiara Camia, Pedagoge, Këshilltare Karriere dhe Ndërmjetësuese Konfliktesh;

Seminar dyditor: Si teknologjia dhe IA po ndryshojnë botën e punës; aplikime në Industrinë e Mikëpritjes. Jorizon Education Consulting (Joy Dong) & Amazing Experience Hospitality Consulting (Andy He), China Skills; Si të transformoni konkurset e aftësive në mësimdhënie në klasë? Si të përdoret IA për trajnimin në shërbimet e hotelerisë dhe mikëpritjes;

Aftësimi Profesional Joformal dhe Informal, kontributi i tij në tregun e punës. Sfidat dhe zhvillimet.

Aftësimi Profesional Joformal dhe Informal; Të mësuarit gjatë gjithë jetës; Të mësuarit për të rriturit; Njohja e të mësuarit joformal dhe informal.



Dita e dytë u mbyll me shpalljen e fituesve të konkursit të kategorisë së Kuzhinës për konkurrentët e moshës 16-25 vjeç dhe Konkursi i Kuzhinës për të Diplomuarit, ku të gjithë konkurrentët dhe juria morën certifikatën e pjesëmarrjes. Gjithashtu sipas vlerësimit të jurisë fituesit ishin:

Kategoria e të diplomuarve;

- Çmimin e tretë: Florian Plakalli
- Çmimin e dytë: Klajdi Rapo
- Çmimin e parë: Mauriçio Begaj

Kategoria e përgjithshme:

- Çmimin e tretë: Fabio Telushi
- Çmimin e dytë: Aleksandër Sogani
- Çmimin e parë: Enri Çuedari

Me ndarjen e çmimeve dhe fotografi në grup u mbyll dhe dita e dytë e Festivalit dhe Konkurseve Kombëtare.



Dita e tretë dhe njëkohësisht dita e fundit ku do të shpallen dhe fituesit për kategoritë e mbetura, mbarte në vetvete dhe ethet e emocionet e të gjithë konkurrentëve të cilët po konkurronin. Kategoritë që konkurruan ishin: Konkursi i Sipërmarrjes dhe Zhvillimit të Biznesit; Konkursi Hotelierisë dhe Restorantit; Konkursi i Zhvillimit të Software; Konkursi i Zhvillimit të Web; Konkursi i Dizajnit Grafik; Konkursi i Fotografisë; Konkursi Parukier dhe Berber; Konkursi për të Diplomuarit në shkolla profesionale drejtimi Hotelieri-Turizëm, mundësuar nga Projekti Erasmus+ VET TO VET ALBANIA Konkursi i Hotelierisë dhe Restorantit.

Ashtu si dhe në ditët e tjera dhe në ditën e fundit u realizuan panele të ndryshme tematike të cilat ishin:

- Qasja ndaj punësimit të personave me aftësi ndryshe. Ndarja e praktikave të mira në vend dhe ato ndërkombëtare, Prezantim EQ Albania-Inteligjenca Emocionale, çfarë është e si mund të përmirësohet, (Rrjeti Botëror i Six Seconds) (Abdullah Veliu, Consultant & Trainer for Supporting Positive Change, Certified Emotional Intelligence, Assessor - Practitioner - Brain Profiler, Six Seconds Network Leader);
- Edukim dhe Udhëzim për Karrierë, Zhvillimet dhe Sfidat Zj.. Gentiana Baholli, Përgjegjëse e Njesisë së Zhvillimit, Koordinatore për Këshillimin dhe Orientimin për Karrierë të nxenesve. Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Zj.. Florida Kumanaku, (mësimdhënëse) Koordinatore e Orientimit në Karrierë, Shkolla Mihal Grameno Tiranë, Zj.Aida Shyti, Këshilluese Karriere, Aleksandër Moisiu University, Ms. Ismail Thaçi, Këshillues Karriere, Aleksandër Moisiu University.





Në përfundim të ditës së fundit u shpërndanë dhe certifikatat, shpallën fituesit për secilën kategori:

Kategori Dizajn Grafik::

- Vendi i parë shkoi për Melisa Rushiti;
- Vendi i dytë shkoi për Leo Meçaj;
- Vendi i tretë shkoi për Erti Mema.

Kategori Zhvillim Faqe:

- Vendi i parë shkoi për Denajdër Bardhi;
- Vendi i dytë shkoi për Endi Malile;
- Vendi i tretë shkoi për Elni Hodo.

Kategoria Berber:

- Vendi i parë shkoi për Kristo Sinjari;
- Vendi i dytë shkoi për Ronaldo Sinani;
- Vendi i tretë shkoi për Joni Xherri.

Kategoria Parukeri:

- Vendi i parë shkoi për Fadil Fadili;
- Vendi i dytë shkoi për Lorena;
- Vendi i tretë shkoi për Sofiola Bezat.

Kategoria Zhvillim Softueri::

- Vendi i parë shkoi për Klajdi Mërdhoçi;
- Vendi i dytë shkoi për Unejsi Isufaj;
- Vendi i tretë shkoi për Kristi Bushi.

Kategoria e Sipërmarrjes dhe Zhvillim i Biznesit:

- Vendi I parë shkoi për grupin Davans
- Vendi I dytë shkoi për grupin Kërko.ev
- Vendi I tretë shkoi për grupin Adapto

Kategoria e Hotelerisë dhe Shërbim Restoranti

- Vendi i parë shkoi për Klevisa Shahllari;
- Vendi i dytë shkoi për Vanesa Furriku;
- Vendi i tretë shkoi për Besjan Shehi.

Kategoria e Fotografisë:

- Vendi i parë shkoi për Aldi Hidi.

Gjate muajit Janar 2024 dhe ne vijim do te punohet per pergatitjen e programit te udhetimeve te te gjithë fituesve te vendeve te para per ne WorldSkills 2024, 10-15 Shtator 2024. Nderkohe fituesit e kategorise se Gatimit do te udhetojne ne Lyon dhe Alba per praktika profesionale tremujore te paguar nga programi Erasmus+ VET TO VET ALBANIA.

Per fituesit e vendeve te dyta dhe te treta do te ofrohen praktika profesionale dhe mundesi punesimi prane bizneseve shqiptare, dhe te gjithë do te kontaktohen individualisht rast pas rasti.



NË NUMRIN E ARDHSHËM

Përvojat e nxënësve gjatë lëvizshmërisë për të mësuarit në Alba Itali dhe Lyon Francë.

Në kuadrin e projektit Vet to Vet Albanian do të kemi dëshmi të nxënësve nga shkollat profesionale Kamëz dhe Hoteleri Turizëm Tiranë pjesëmarrës në mobilitet afatshkurtër në Alba Itali dhe Lyon Francë. Nxënësit do të na tregojnë eksperiencën e tyre të parë në mobilitet, sfidat, përshatja, përvoja në kompanitë atje etj.

Studentët nga Italia--Përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, në kuadër të Erasmus+

Përgjatë muajit Shkurt 2024 Albanian Skills do të mikpres studentë nga Italia të cilët do të realizojnë praktikat profesionale njëmuje pranë kompanive shqiptare.



Projektet Erasmus+ AFP

Në numrin e ardhshëm të Buletin do të lexoni artikuj të ndryshëm për aktivitetet dhe eventet që do të mbahen në kuadër të projekteve Erasmus +; Candi; -DC-Vet Albania; Vet to Vet Capacity Building in Albania. Për secilin nga projektet janë planifikuar, takime ndërkombëtare me partnerët, aktivitete me aktorë të ndryshëm të përfshirë etj.

Gjithashtu do të njiheni edhe me tre projekte e reja Erasmus + që kanë nisur që prej Dhjetor 2023/ Janar 2024.

Edicioni i 8-të i Konkurse Kombëtare të Aftësive

Në bulletinin e ardhshëm do të lexoni artikuj, dëshmi të konkurentëve pjesëmarrës dhe të jurisë. Ato do të tregojnë emocionet dhe ndjesitë e tyre që kanë përjetuar përgjatë kësaj eksperience 3 ditore.

Festivali i Aftësive, Karrierës dhe Punës 2024 - Edicioni Dytë



Edicioni 9-të i Konkurseve Kombëtare të Aftësive Profesionale



BUILDING DIGITAL TEACHING CAPACITIES OF VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING TEACHERS in Bosnia and Herzegovina and Albania

To promote readiness for digital education in Bosnia and Herzegovina and Albania



To improve innovation modernization and internationalization of Vocational Education and Training (VET) schools in Albania.



CAPACITY BUILDING in the field of Vocational Education and Training (DC-VET WB)

To innovate VET systems in Western Balkans through the exchange of practices and a pervasive capacity-building action.

